

VENDIM
Nr. 114, datë 14.5.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEMAN2SUN” SHPK, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK SEMAN-
2, SHEQ, MARINAS, FIER, ME FUQI TË INSTALUAR 2000 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.5.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “Seman2Sun” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-2, Sheq, Marinas, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 309 prot., datë 11.4.2018, shoqëria “Seman2Sun” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-2, Sheq, Marinas, Fier, me kapacitet të instaluar 2000 kw.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën, nr. 3888/2, datë 29.12.2017, ka dhënë miratimin përfundimtar për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, në zonën Sheq, Marinas, Seman, Fier.

- ERE, me vendimin nr. 94, datë 20.4.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Seman2Sun” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Seman-2, me kapacitet të instaluar 2000 kw.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, me shkresën nr. 55/23 prot., datë 20.4.2018, u publikua njoftimi në median e shkruar dhe me mbarimin e afateve të publikimit rezulton se nuk ka asnjë ankesë apo objeksion nga palë të interesuara.

- Gjithashtu, ERE, me shkresën nr. 309/1 prot., datë 26.4.2018, i ka kërkuar subjektit të plotësorë dokumentacionin e munguar në aplikim, për sa i përket oponencës teknike të projektit të zbatimit dhe dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare.

- Me shkresën nr. datë 10.5.2018, subjekti ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- Oponencë teknike e datës 26.4.2018 nga “GR Albania”, kompani e licencuar në këtë fushë.
- Konfirmim nga Banka Credins nr. 453 prot., datë 8.5.2018, nga rezulton gjendja e depozitave.
- Pas këtij plotësimi, rezulton se aplikimi i shoqërisë “Seman2Sun” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionit tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Seman2Sun” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik Seman-2, Sheq, Marinas, Fier me kapacitet të instaluar 2000 kw, për një afat 20-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti